



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI PORTUAL Durrës

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje pjesë këmbimi Elektrike Elektronike për Vinca Mobile ”
(Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar- Mall)

VLERA E FONDIT LIMIT: 18.000.000 (tetembedhjetë milion) leke pa tvsh ose 184.842,88 (njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind e dyzet e dy presje tetëdhjetë e tetë) Euro, pa TVSH.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Pjesë për vinça 42419100-7

Afati i lëvrimit do jetë **12 (dymbëdhjetë) muaj** nga data e nënshkrimit të marreveshjes kuadër.

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (sipas shtojcës 8).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre vitet e fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera së fondit limit.

2.3 Kapaciteti teknik:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përllogaritur të fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen **vërtetime** të lëshuara nga një ent publik ose **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e furnizimet e realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e furnizimet e realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.

3 Ofert Teknike

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për mallrat e listes në formatin e **Ofertes Teknike**, në formën e një tablele sipas modelit të mëposhtëm, e cila duhet të plotësohet në mënyrë rigoroze. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë;

- Emri i kompanisë prodhuese
- Emërtimi i Katalogut të prodhuesit ose i skedës teknike
- Numri i faqes në katalog ose në skedën teknike ku ndodhet artikulli
- Numri (kodi) identifikues i artikullit të ofruar, i shënuar me një shenjë dalluese

Të dhënat e deklaruara në ofertën teknike duhet të korespondojnë me të dhënat për artikujt në katalogët/skedat teknike të dorëzuara. Moskorespondimi i këtyre të dhënave do të sjellë pavlefshmëri të ofertës.

Argumentim: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

- Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standardet e kerkuara, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit/ve per listen e mallrave objekt prokurimi, ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte materialet qe do te ofrohen.

Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

Argumentim: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

4 Mostrat

Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara, operatori ekonomik ofertues në ditën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë mostra për zërat si më poshtë:

Mjeti	Nr.Idetifikues	Emertimi	Njesia	Sasia
FTMH	1523968	PHOENIX Y DISTRIBUTOR 1523968	cope	1
FTMH	300064	PRESSURE TRANSMITTER	cope	1
KALMAR	920169.011	TEMPERATURE SWITCH	cope	1
KALMAR	923855.1822	sensor	cope	1
ITALGRU	3E77000109	Joystick	cope	1
ITALGRU	3RT2936	RELAY	cope	1
ITALGRU	15LS B100000139	SENSOR GRASE	cope	1
ITALGRU	3H71000005	Pressor switch	cope	1
MHC 200	114.060.2002	Joystick	cope	1
SPREADER RAM	2E06-00086	NANHUA LED 24VDC RED-M12	cope	1

Argumentimi i marrëveshjes kuadër:

1. Marrëveshja kuader do të lidhet me një operator ekonomik pasi janë të përcaktuara të gjitha kushtet kryesore të tilla si: artikujt, specifikimet e sakta teknike, afatet e lëvrimit, si dhe sasi të qe priten të furnizohen.

2. Nga përvoja e prokurimit të artikujve (objekt i kësaj procedure) në vite, çmimet e tregut kanë rezultuar të jenë të qëndrueshëm dhe nuk ndryshojnë.

3. Në rast se kjo marrëveshje do të lidhet me disa OE do të shkaktonte kosto shtesë dhe vështirësi autoritetit kontraktor si p.sh mospërputhje të artikujve të dhënë në bazë të rendit, pjesë të tyre të përbashkëta.

Afati i marrëveshjes kuadër do të jetë 12 (dymbëdhjetë) muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kerkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara

nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

KUSHTET PER TU ZBATUAR NE PRANIM.

A. Në fazen e pranimit, janë të detyruar të paraqesin;

- 1. Dokumente origjinale** ose te njevlefshme, te deklaruar ne institucionet tona zyrtare, me ane te te cilave te demonstronhet, se sherbimet jane kryer Referuar ANEX-I me ate te paraqitura ne dokumentet e ofertimit.
- 2. Dokumente origjinale** ose te njevlefshme, te deklaruar ne institucionet tona zyrtare, me ane te te cilave te demonstronhet produktet e ofruara

VERIFIKIMI DOKUMENTEVE TE DOREZUARA

AUTORITETI KONTRATOR, rezervon te drejten te kryeje, te gjitha verifikimet qe i konsideron te nevojshme, per tu garantuar mbi vlefshmerine e dokumenteve te kerkuara.

KOMISIONI I PERCAKTIMIT TE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PERLLOGARITJES SE VLERES SE FONDIT LIMIT